


REPublika e Kosovës - Republika Kosovo
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUÇITRN

02 Nr. / Br 748/22

Nr. i fq. / Br. st -03-

Data: / Datum 06.06.2022

VUSHTRRI - VUÇITRN



Komuna Vushtrri

MARRËVESHJE BASHKËFINANCIMI

PËR FINANCIM TË PËRBASHKËT TË PROJEKTIT – NDËRTIMI I SHTËPIVE PËR BANIM PËR FAMILJE TË CILAT NUK E KANË TË ZGJEDHUR ÇËSHTJEN E BANIMIT NË KOMUNËN E VUSHTRRISË

Palët Nënshkruese të marrëveshjes:

1. Komuna e Vushtrrisë, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës **Z. Ferit Idrizi** (në tekstin e mëtejme Komuna),
2. Shoqata Bamirëse “Jetimat e Ballkanit” Rr. Bekim Muhaxhiri nr. 18 Prizren, të cilën e përfaqëson **Z. Berat Kabashi**, (në tekstin e mëtejme Shoqata)

Neni 1 Qëllimi

- 1.1 Qëllimi i lidhjes së kësaj marrëveshje është bashkëfinancimi i projektit “Ndërtimi i njëzet (20) Shtëpive për banim në Komunën e Vushtrrisë për familje në nevojë të cilat nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit” dhe përcaktimi i obligimeve të palëve për realizimin e këtij projekti.
- 1.2 Në rast se komisioni gjen banese me çmim të njejtë të shtëpive për banim sipas marrëveshjes së bashkëfinancimi atëherë për të njëjtën mund të blihet banesë.

Neni 2 Realizimi i projektit

Projekti “Ndërtimi i njëzet (20) Shtëpive për banim në Komunën e Vushtrrisë për familje në nevojë të cilat nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit” do të financohet me buxhetin e komunës dhe financim të Shoqatës Bamirëse “Jetimat e Ballkanit” në mënyrën e përcaktuar në nenet e poshtëshënuara.

Neni 3
Obligimet e përbashkëta të palëve nënshkruese të marrëveshjes

Komuna e Vushtrrisë dhe Shoqata Bamirëse “Jetimat e Ballkanit” përmes komisionit të përbashkët do të identifikojnë familjet të cilat nuk e kanë të zgjedhur çështjen e banimit dhe hartojnë listën përfundimtare të familjeve të cilat do të jenë përfitues të këtij projekti.

Neni 4
Obligimet e Komunës së Vushtrrisë

4.1 Komuna e Vushtrrisë merr përsipër që të participoj me mjete financiare nga buxheti i saj për ndërtim të njëzet (20) shtëpive për banim në vlerë me nga tetmijë euro (8,000.00 €) për secilën shtëpi. Pagesa do të bëhet nga fondi i subvencioneve dhe transfereve të njësisë buxhetore në të cilat ka mjete financiare të lira.

4.2 Pagesa e mjeteve financiare të cekur si në pikën paraprake do të bëhet në llogarinë bankare të Shoqatës Bamirëse “Jetimat e Ballkanit” nr. XK051110318280000140 në Pro Credit Bank.

4.3 Pagesa e mjeteve bëhet pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje, në pajtim me legjislacionin në fuqi në Kosovë.

4.4 Komuna e Vushtrrisë merr përsipër që të ia dorëzoj me kohë Shoqatës Bamirëse “Jetimat e Ballkanit” dëshmitë për zotim të mjeteve për këtë projekt.

4.5 Komuna e Vushtrrisë cakton menaxherin/organin mbikëqyrës (zyrtar komunal) për përcjellje të punimeve me rastin e realizimit të projektit si dhe për inspektimin final të punimeve/pranimin teknik.

4.6 Menaxheri i projektit/organi mbikëqyrës do të vërteton sasitë dhe kualitetin e punëve të kryera.

Neni 5
Obligimet e Shoqatës Bamirëse “Jetimat e Ballkanit”

5.1 Shoqata Bamirëse “Jetimat e Ballkanit” merr përsipër që të siguroj mjete financiare të nevojshme për ndërtim të njëzet shtëpive për banim, përtej shumës të cilën e siguron komuna e Vushtrrisë siç është cekur në nenin 4 pika 4.1 të kësaj marrëveshje.

5.2 Shoqata do të përzgjedhë operatorin/ët ekonomik (punëkryesit) për ndërtim të shtëpive për banim të paraparë me këtë marrëveshje.

5.3 Shoqata Bamirëse “Jetimat e Ballkanit” do të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme që projekti të përfundoj brenda vitit 2022. Në rast se për shkaqe të arsyeshme ky projekt nuk mund të kryhet brenda këtij afati atëherë palët dakordohen që ky projekt të vazhdoi në vitin 2023 dhe përfundoj më së largu deri në fund të këtij viti.

5.4 Shoqata do ta njoftoj Komunën për rrjedhat e realizimit të projektit sipas një plani një mujor deri në përfundimin të tij.

5.5 Shoqata vendos në punishte tabelën informuese (Pano) standarde me shënimet për projektin, investitorët dhe operatorin ekonomik.

Neni 6 **Ndryshimet dhe plotësimet e marrëveshjes së bashkëfinancimit**

Me pëlqimin paraprak të Shoqatës Bamirëse “Jetimat e Ballkanit” dhe Kryetarit të Komunës, kjo Marrëveshje e Mirëkuptimit mund të ndryshohet dhe plotësohet.

Neni 7 **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Palët pajtohen që mosmarrëveshjet eventuale të i zgjidhin me mirëkuptim.

Neni 8 **Hyrja në fuqi**

Palët nënshkruese pajtohen që marrëveshje e mirëkuptimit hyn në fuqi dhe fillon të zbatohet nga dita e nënshkrimit.

Neni 9 **Numri i faqeve dhe neneve**

Marrëveshja e mirëkuptimit ka dhjetë (10) nene në tri (3) faqe A/4.

Neni 10 **Numri i ekzemplarëve**

Kjo marrëveshje e mirëkuptimit është hartuar në tre (3) ekzemplarë në origjinal, dy (2) për Komunën e Vushtrrisë dhe një (1) për Shoqatën Bamirëse “Jetimat e Ballkanit”.

Vushtri, më 06.06. 2022

Shoqata Bamirëse “Jetimat e Ballkanit”


Z. Berat Kabashi



Komuna e Vushtrrisë


Z. Ferit Idrizi, Kryetar

